


RENOVA®

*Innovation & Performance*

# RENOFIX 202

## GLET MASË NË BAZË GËLQERE PËR RRAFSHIM (PATINIM)

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik

**HAPËSIRAT E PËRDORIMIT**

Masë rrafshuese (glet masë) e rafinuar, jo hidrofobe, në bazë gëlqereje, për rrafshim (patinim). Përdoret për krijimin e sipërfaqeve të lëmuara mbi llaçet themelore. Përdoret për sipërfaqe të mureve të brendshëm, paraprakisht të suvatuara me llaç themelor (gips, gëlqere, çimento), si dhe pllaka gips kartoni. Mbi këtë material nuk preferohet ngjitja e pllakave.

**PËRMBAJTJA**

- Gëlqere në pluhur
- Pluhur i bardhë mermeri
- Përbërës organikë <5%

**VEÇORITË**

- Përpunim i mirë dhe efikas
- Sipërfaqe e lëmuar, e përshtatshme për shlajfim
- Shkallë e lartë e difuzionit

**PËRGATITJA E BAZËS**

Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe sipërfaqet e lyera me ngjyra të shkëlqyera. Lagështia e bazamentit duhet të jetë nën 2.5% nga masa (sipas CM matjeve). Nëse në mur ekzistojnë fuga apo çarje të hapura, ato duhet paraprakisht të mbyllen. Llaçet themelore çimento - gëlqerore paraprakisht duhet të jenë tharë dhe të jenë të vrazhdë.

**PËRGATITJA E LLAÇIT**

Një thes **Renofix 202** zbrazet në 12-13 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser dore derisa të fitohet masë homogjene. Pas përzierjes, materiali duhet të qëndrojë për 10 minuta. Më pas, përzihet sërish për një kohë të shkurtë.

**PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT**




Materiali bartet me mistri çeliku / gletkele. Trashësia e shtresës duhet të jetë 1-3 mm. Për cilësi të lartë të sipërfaqeve, mund, sidomos te llaçet e vrazhda themelore pas tharjes së shtresës së parë, të vendoset edhe shtresa e dytë. Përzierja e freskët duhet të përdoret brenda 6 orëve. Gjatë tharjes kujdesuni për ajrosje të mjaftueshme. Sipërfaqet e pa rrafshuara që janë formuar gjatë përpunimit mund të rrafshohen me letër grysese me granu-

# RENOFIX 202

RENOVA®
Innovation & Performance

PUTZ

**PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT**

lacion 180/220. Më pas, sipërfaqja është e gatshme për ngjyrosje. Mbështjellja me tapeta mund të kryhet vetëm pas tharjes së plotë të materialit. Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5 C. Nuk lejohet përzierjamemateriale tjera.

**VËRREJTJE**

Për udhëzime të hollësishme të sigurisë, këshillohuni me fletët e veçanta të sigurisë. Ju lutemi lexoni broshurën e sigurisë para përdorimit.

**PAKETIMI**

**Renofix 202** furnizohet në thasë letre nga 25 kg që janë të mbrojtura nga lagështia.

**DEPONIMI**

Ruani në një vend të thatë (nëse është e mundur në paletë druri). Afati i deponimit: 3 muaj sipas Rregullores 1907/2006/EU, Shtojca XVII në 20°C, 65% l. r. e ajrit.

**TË DHËNA TEKNIKE**

| | |
|---|---|
| Numri i prodhimit | 5319990620101 |
| Shifra e prodhimit | 1202 |
| Thasë në paletë | 42 |
| Struktura e llaçit | Glet masë |
| Ngjyra | E BARDHË |
| Sasia e nevojshme e ujit | 12-13 l./Thes |
| Harxhimi | 1,5 kg/m$^2$ për trashësi të shtresës prej 1mm |
| Trashësia e shtresës | 1-3 mm |
| Shënim | Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit. |
| Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10) | ca 1000 kg/m3 |
| Përçueshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002) | 0,3 W/mK |
| Kapaciteti i veçantë i nxehtësisë | 1 J/kg K |
| Vlera e pH | ca 12 |
| Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11) | ca 1 N/mm2 |
| Reagimi gjatë djegjes | F |
| MG (EN 998-1): | GP CS I W0 |

Të gjitha të dhënat për materiali pushon së qeni e vlefshme pas lëshimin e sa më sipër listë. Këto janë të dhënat që rezulton nga rryma jonë analiza. Jo ligjore mund të lindë detyrimi këto të dhëna. Produktet RENOVA, si dhe të gjitha të papërpunuara materialet e përfshira në ato i nënshtrohen të vazhdueshme, të vazhdueshme teste për të siguruar konstante dhe të njëjtin nivel të cilësisë. Këshilltarët tanë teknikë janë në dispozicionin uaj çdo kërkesë lidhur me Aplikacioni, përpunimit, dhe prezantimin e tona produktet.
Ju mund ta gjeni të dhënat tona aktuale në www.renova.com.mk, si një "PDF" dokument ose pyesni për ta në dyqane me pakicë.


RENOVA MAQEDONI
Xhepcisht / Tetovë
Tel: +389 44 487 300
Fax: +389 44 487 200
info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPERI
Picar / Vore
Tel: +355 48 301 909
Fax: +355 48 301 908
tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVË
Gurëza / Ferizaj
Tel: +381 290 310 222
Fax: +381 290 310 444
ferizaj@renova.com.mk


COMPANY CERTIFIED BY
EN ISO 9001
Certificate No: FM 503328

www.renova.com.mk